

Organizata për siguri dhe bashkëpunim në Evropë MISIONI NË KOSOVË

Raporti 04/2007 i Shtyllës së III-të (OSBE) Mbi monitorimin e Kuvendit të Kosovës 23 korrik 2007 – 23 shtator 2007

Përmbledhje

Gjatë periudhës raportuese, Grupi i Unitetit ka raportuar para Kuvendit lidhur me vazhdimin e bisedimeve për statusin. Anëtarët e Grupit të Unitetit pohuan se nuk do të pranojnë asnjë shtyerje të mëtejshme të zgjidhjes së statusit dhe se SHBA-të dhe shumica e vendeve të BE-së vazhdojnë ta përkrahin propozimin gjithpërfshirës për statusin të z. Martti Ahtisaari. Rreth dyzet deputetë të Kuvendit e morën fjalën dhe e konfirmuan mbështetjen e tyre për Grupin e Unitetit.

Kryeministri dhe Ministri për Arsim iu drejtuan Kuvendit në përgjigje të interpelancave të ORA-s. Kryeministri iu përgjigj interpelancës lidhur me procedurat e tenderimit për licencimin e operatorit të telefonisë së dytë mobile, derisa Ministri për Arsim iu përgjigj interpelancës lidhur me zbatimin e reformës së klasës së pestë në shkollat fillore.

Kuvendi ka miratuar në parim projektligjin për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetëve, i cili synon ta rregullojë statusin, imunitetin dhe kompenzimin e deputetëve të Kuvendit si dhe mospërputhshmërinë e mandatit të tyre me funksionet e tjera në sektorin publik dhe atë privat.

Kuvendi ka themeluar komisionet *ad hoc* për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të RTK-së dhe Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media (KPM). Në pajtim me Ligjin për RTK-në dhe Ligjin për KPM-në, komisionet *ad hoc* përbëhen nga një përfaqësues prej secilit entitet politik të përfaqësuar në Kuvend.

1. Sfond

Raporti i pesëdhjetetretë i monitorimit është hartuar në përputhje me pikëpamjet referuese të Shtyllës së tretë të UNMIK-ut për themelimin e institucioneve (OSBE) dhe monitorimin e Kuvendit të Kosovës prej datës 26 nëntor 2002 dhe bazohet në Rregulloren e re të punës, të miratuar në fund të seancës plenare më 20 maj 2005 dhe të reviduar në seancën e mbajtur më 1-2 qershor 2006.

Gjatë periudhës raportuese, Kuvendi ka mbajtur katër seanca plenare të rregullta, më 27/31 korrik, 30 korrik, 27 gusht dhe 14/17 shtator si dhe dy mbledhje të rregullta të Kryesisë, më 20 gusht dhe 6 shtator. Dhjetë komisionet dhe nënkomisioni për të drejtat e njeriut, barazi gjinore, peticione dhe ankesa publike kanë mbajtur mbledhje gjatë periudhës raportuese. Shtylla e III-të (OSBE) i ka monitoruar seancat plenare dhe mbledhjet e Kryesisë, si dhe 22 prej 39 mbledhjeve të komisioneve dhe tri dëgjime publike.

2. Vështrim

Seancën plenare të Kuvendit të Kosovës të mbajtur më 27/31 korrik e kryesoi Kryetari i Kuvendit Kolë Berisha dhe anëtari i Kryesisë z. Naim Maloku (AAK).

- Shtatëdhjetë e dy dhe 75 deputetë ishin të pranishëm më 27, përkatësisht 31 korrik.
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare të 27/31 korrikut:
 - Pyetjet për Qeverinë për përgjigje gojore
 - Interpelanca e ORA-s për Kryeministrin (Shiko më poshtë pjesën e titulluar “Interpelanca”.)
 - Shqyrtimi i parë i projektligjit për ndihmë familjeve me fëmijë me paaftësi të përhershme (Projektligji është miratuar në parim me 63 vota për dhe shtatë vota kundër.)
 - Shqyrtimi i parë i projektligjit për letërnjoftimin

- (Projektligji është miratuar në parim me 63 vota për dhe pesë vota kundër.)
- Shqyrtimi i parë i projektligjit për ndërtimet pa leje
(Projektligji është miratuar në parim me 50 vota për dhe pesë votë kundër.)
- Debat për ndërtimet pa leje të ndërtesave në pjesën veriore të Mitrovicës/Mitrovica nga ana e Qeverisë së Serbisë
(Z. Ramadan Kelmendi (LDD) si sponsorues i debatit bëri deklaratën hyrëse pasuar nga Ministri për Ambient dhe planifikim hapësinor, shefat e grupeve parlamentare, disa deputetë dhe deklarata mbyllëse e z. Kelmendi. Deklarata e propozuar nga z. Kelmendi nuk është votuar për shak të mungesës së kuorumit.)
- Shqyrtimi i rekomandimit të komisionit për çështje gjyqësore, legjislative dhe Kornizë Kushtetuese lidhur me emërimin e një anëtari në bordin drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës, të propozuar nga Zyra e Prokurorit Publik
(Kjo pikë është shtyrë për shkak të mungesës së kuorumit.)

Seancën plenare të Kuvendit të Kosovës të mbajtur më 30 korrik e kryesoi Kryetari i Kuvendit Kolë Berisha (LDK) dhe anëtari i Kryesisë z. Xhavit Haliti (PDK).

- Tetëdhjetë e një deputetë ishin të pranishëm në seancën plenare të 30 korrikut.
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare të 30 korrikut:
 - Debat mbi vazhdimin e bisedimeve për statusin politik të Kosovës
(Në fillim të debatit të gjithë anëtarët e Grupit të Unitetit bënë deklaratë pasuar nga shefat e grupeve parlamentare, debati i gjërë plenar dhe deklaratat mbyllëse të të gjithë anëtarëve të Grupit të Unitetit.)

Seancën plenare të Kuvendit të Kosovës të mbajtur më 27 gusht e kryesoi Kryetari i Kuvendit Kolë Berisha (LDK) dhe anëtari i Kryesisë z. Sabri Hamiti (LDK).

- Gjashtëdhjetë e pesë deputetë ishin të pranishëm në seancë më 27 gusht.
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare të 28-29 qershorit:
 - Pyetjet për Qeverinë për përgjigje me gojë
 - Shqyrtimi i parë i projektligjit për ndryshimin e ligjit Nr 2003/11 për rrugët
(Projektligji është miratuar në parim me 67 vota për dhe pa vota kundër.)
 - Shqyrtimi i parë i projektligjit për organizimin e institucioneve të kadastrit
(Projektligji është refuzuar me 25 vota për dhe 30 vota kundër.)
 - Shqyrtimi i projektligjit për vlerësimin e ndikimit në mjedis
(Projektligji është miratuar në parim me 61 vota për dhe gjashtë vota kundër.)
 - Shqyrtimi i raportit për vitin 2006 të Zyres së Rregullatorit të Energjisë
(Raporti është miratuar me 47 vota për dhe tetë vota kundër.)
 - Shqyrtimi i rekomandimit lidhur me transferimin e fondeve në Zyren e Rregullatorit të Energjisë
(Rekomandimi është miratuar me 50 vota për dhe 18 vota kundër.)
 - Shqyrtimi i projektrezolutës së propozuar nga Komisioni për ekonomi, tregti, industri, energji, transport dhe komunikacion lidhur me minierën “Trepça/Trepça”
(Kjo pikë është shtyrë me kërkesën e Komisionit.)
 - Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për çështje gjyqësore, legjislative dhe Kornizë Kushtetuese lidhur me emërimin e një anëtari në bordin drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës të propozuar nga Zyra e Prokurorit Publik
(Emërimi është miratuar me 55 vota për dhe 12 vota kundër.)

Seancën plenare të Kuvendit të Kosovës të mbajtur më 14 dhe 17 shtator e kryesoi Kryetari i Kuvendit Kolë Berisha (LDK) dhe anëtari i Kryesisë z. Gazmend Muhaxheri (ORA).

- Tetëdhjetë e tre dhe 78 deputetë ishin të pranishëm më 14, përkatësisht 17 shtator.

- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare të 12 korrikut:
 - Pyetjet për Qeverinë për përgjigje me gojë
 - Interpelanca e ORA-s për Ministrin për Arsim, Shkencë dhe Teknologji (Shiko më poshtë paragrafin e dytë të pjesa “Interpelanca”.)
 - Shqyrtimi i parë i projektligjit për Vlerësimin Strategjik të Mjedisit (Projektligji është miratuar në parim me 62 vota për dhe një votë kundër.)
 - Shqyrtimi i parë i projektligjit për Procedurën jokontestimore (Projektligji është miratuar në parim me 53 vota për dhe dy vota kundër.)
 - Shqyrtimi i parë i projektligjit për procedurën përmbaruese (Projektligji është miratuar në parim me 60 vota për dhe dy vota kundër.)
 - Shqyrtimi i parë i projektligjit për procedurën kontestimore (Projektligji është miratuar në parim me 59 vota për dhe katër vota kundër.)
 - Shqyrtimi i parë i projektligjit për të drejtat dhe obligimet e deputetëve të Kuvendit (Projektligji është miratuar në parim me 72 vota për dhe një votë kundër.)
 - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për ushqimin (Kjo pikë është shtyrë me kërkesë të komisionit funksional)
 - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për ndryshimin e ligjit Nr. 2004/01 për transportin rrugor (Projektligji është miratuar me 66 vota për dhe pa vota kundër.)
 - Shqyrtimi i propozimeve të partive politike të përfaqësuara në Kuvend lidhur me emërimin e kandidatëve në komisionin *ad hoc* për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të RTK-së. (Emërimi i anëtarëve është miratuar me shumicë votash për dhe pa vota kundër.)
 - Shqyrtimi i propozimeve të partive politike të përfaqësuara në Kuvend lidhur me emërimin e kandidatëve në komisionin *ad hoc* për përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Komisionit të Pavarur të Mediave. (Emërimi i anëtarëve është miratuar me shumicë votash për dhe pa vota kundër.)
 - Shqyrtimi i rekomandimit lidhur me transferimin e fondeve në Ministrinë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural (Rekomandimi është miratuar me 56 vota për dhe shtatë vota kundër.)
 - Shqyrtimi i raportit fiskal për gjysmën e parë të vitit 2007 (Kryesuesi i Komisionit për Buxhet Naser Osmani (LDK) bëri deklaratën hyrëse pasuar nga Ministri për Ekonomi dhe Financa Haki Shatri, përfaqësuesit e grupeve parlamentare dhe disa deputetë të tjerë.)
 - Shqyrtimi i propozimit të Qeverisë lidhur me emërimin e një anëtari të Bordit Drejtues të Autoritetit Qendror Bankar (Emërimi është miratuar me 50 vota për dhe katër vota kundër.)

3. Punimet dhe praktikat parlamentare në seancat e Kuvendit

Rendi i ditës

- Në fillim të seancës plenare të 27 korrikut, Kryetari i Kuvendit lajmëroi se për ndryshimin e rendit të ditës në pajtim me rregullën 23.2 ishin paraqitur tri propozime *me shkrim* para fillimit të seancës plenare. Ai deklaroi se grupi parlamentar i PDK-së, Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Ambient dhe Planifikim Hapësinor dhe Komisioni për Siguri kishin propozuar që debati për zjarret të futet në rendin e ditës. Ai i hedhi në një votim të vetëm të tri propozimet meqë ato kishin objekt të njëjtë, të cilat u miratuan me shumicë votash për dhe pa vota kundër. Në fillim të seancës plenare të 27 gushtit, në emër të LDD-së, znj. Besa Gaxherri *gojarisht* propozoi që Kuvendi të merr vendim gjatë asaj seance për t'i urdhëruar të gjitha institucionet publike që ta vendosin portretin e Kryetarit të ndjerë Ibrahim Rugova, në shenjë respekti për personalitetin e tij. Ajo insistoi që propozimi të hedhet në votim gjatë seancës në fjalë. Kryetari i Kuvendit u përgjigj se ajo duhet ta bëjë propozimin e saj në pajtim me Rrefulloren e punës. Në seancën e njëjtë, pas deklaratës së znj. Gaxherri, Z. Gjergj Dedaj (Për Integritim) kërkoi fjalën dhe i u lejua ta bëjë këtë. Ai deklaroi se dëshiron të ngrisë shqetësimin lidhur me shpalljen se zgjedhjet parlamentare dhe lokale do të mbahen në nëntor. Për më tepër ai u ankua se partitë e

vogla ishin përjashtuar nga procesi i vendimmarrjes lidhur me zgjedhjet dhe shtoi se sipas tyre [partive të vogla] prioritet duhet t'i ipet statusit të Kosovës dhe se me zgjedhjet duhet të trajtohen pas zgjidhjes së statusit. Gjatë diskutimit, mikrofonin e tij është çkyçur automatikisht pas arritjes së limitit kohor prej dy minutash për diskutim lidhur me rendin e ditës, dhe Kryetari i Kuvendit vazhdoi me pikën e radhës në rendin e ditës duke mos i lejuar z. Dedaj ta përfundojë diskutimin e tij.

Në seancën plenare të 14 shtatorit, nuk është bërë asnjë propozim me shkrim apo gojor për ndryshimin e rendit të ditës

Rregullat e reja 23.1-2 parashohin që “Kryesia përgatitë një propozim të rendit të ditës për seancën e radhës të Kuvendit dhe menjëherë të njëjtin e vë në dispozicion për deputetët e Kuvendit. Në fillim të seancës ky propozim rend dite do të konsiderohet i miratuar, përveç nëse një ose më shumë grupe parlamentare apo 6 deputetë i propozojnë me shkrim Kryetarit një amendament në rendin e ditës, i cili hidhet në votim.” Ndryshe nga propozimi i znj. Gaxherri për ndryshimin e rendit të ditës të seancës plenare të 27 gushtit, të tri propozimet e përmendura më lartë për ndryshimin e rendit të ditës të seancës plenare të 27 gushtit janë bërë në pajtim me Rregullorat e reja. Andaj, nuk ka pasur shkelje të rregullores në atë që propozimi i znj. Gaxherri nuk është vënë në votim. Sa i përket diskutimit të z. Dedaj, nuk është e qartë nëse ai ka dashur të bëjë propozim për ndryshimin e rendit të ditës së seancës plenare të 27 gushtit apo të bëjë deklaratë politike. Sipas rregullës 22.7 “diskutimi lidhur me rendin e ditës nuk zgjat më shumë se dy (2) minuta”, sidoqoftë, kjo dispozitë nuk mund të interpretohet në mënyrë të izoluar, por në kontekst të dispozitave 23.1-2 lidhur me përgatitjen e rendit të ditës. Andaj, parakushti për të lejuar deputetin që ta paraqesë gojarisht amendamentin e tij/saj në rendin e ditës të seancës plenare është që ai paraprakisht ta dorëzojë të njëjtin me shkrim para seancës dhe të ketë përkrahjen e të paktën pesë deputetëve të tjerë, siç kërkohet në rregullën 23.2, përndryshe rendi i ditës konsiderohet i miratuar. Z. Dedaj nuk ka paraqitur propozim me shkrim për ndryshimin e rendit të ditës, andaj fakti që atij nuk i është lejuar ta përfundojë diskutimin e tij nuk përbën shkelje procedurale. Nëse znj. Gaxherri dhe z. Dedaj dëshirojnë të parashtrajnë çështje për diskutim në Kuvend, mund ta bëjnë këtë duke e shfrytëzuar rregullën 6.5 sipas të cilës “Kryesia siguron që çfarëdo mocioni përmbajtësor që mbështetet nga gjashtë ose më shumë deputetë të Kuvendit, të futet në rendin e ditës të seancës plenare të Kuvendit brenda tri javësh pune, nga dita kur është marrë kjo shkallë e mbështetjes.”

Mocioni procedural

- Në fillim të seancës plenare të 27 korrikut, z. Xhevat Bislimi (PDK) kërkoi fjalën duke deklaruar se dëshiron të propozojë mocion procedural. Ai propozoi mocionin procedural për shtyerjen e seancës duke propozuar se deputetët do të duhej të ishin në Junik (komuna e Deçanit/Deçane) për të nderuar luftëtarin e rënë të UÇK-së Edmond Hoxha, monumenti i të cilit ngritej atë ditë në Junik, në vend se të mbajnë seancë plenare. Kryetari i Kuvendit e hedhi në votim mocionin për shtyerjen e seancës plenare për datën 31 korrik, i cili është miratuar me 25 vota për dhe një votë kundër.

Kjo është në pajtim me rregullën 30.1-2 e cila parasheh që “Në çdo seancë plenare të Kuvendit deputeti i jepet e drejta të propozojë mocion për ta shtyrë seancën. Për mocionin për ta shtyrë seancën, menjëherë mbahet votim pa debat.”

Rendi në punimet e Kuvendit

- Në mbledhjen e Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim të mbajtur më 20 shtator, Kryesuesi Randjel Nojkić (SLKM) e informoi komisionin se Zyra Ligjore e UNMIK-ut i kishte dërguar disa komente Kuvendit me kërkesë të rishqyrtohen Ligji për emrin personal dhe Ligji për numrin personal. Ai komentoi më tutje se Kuvendi po i miraton ligjet duke i shkelur të drejtat e komuniteteve joshumicë “duke u sjellur si Millosheviqi i cili vepronte kundër interesave të të tjerëve”. Disa deputetë fuqimisht kundërshtuan komentin e z. Nojkić dhe kërkuan nga ai mos ta krahasojë Kuvendin me regjimin e Millosheviqit.

Rregulla 41.3 parasheh që dispozitat për seancat plenare në mënyrë analoge të zbatohen edhe në komisione. Në këtë kontekst, rregulla 22.11 parasheh që Kryetari i Kuvendit [gjithashtu vlen edhe për kryesuesit e komisioneve] mban rendin dhe mund të urdhërojë deputetin, i cili sipas mendimit të tij ka përdorur “gjuhë joparlamentare” që, ndër të tjera, definohet si “fyerje, shpifje ose kërcënim; gjuhë e pahijshme; apo që nxit dhunë ndëretnike”, t’i tërheqë fjalët e tilla. Rregullorja nuk saktëson rastet kur kryesuesi i komisionit apo i seancës plenare përdor gjuhë, e cila konsiderohet nga deputetët tjerë si ofenduese. Rregullorja e punës e Kuvendit të Shqipërisë, ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, Kroacisë, Sllovenisë, Francës, Bundestagut Gjerman dhe Dhomës së Përfaqësuesve të Parlamentit të Belgjikës, poashtu parashohin që Kryetari apo kryesuesi ka përgjegjësi për të mbajtur rendin dhe për të siguruar zbatimin e rregullores. Poashtu, rregulloret e punës të organeve të lartëpërmendura ligjvënëse nuk përmbajnë dispozita për rastet kur deputetët ndihen të ofenduar nga kryesuesi, meqë praktika parlamentare parasheh që kryesuesi së pari i përmbahet rregullave para se të kërkojë nga të tjerët që ta bëjnë këtë. Kuvendi i ardhshëm i Kosovës mund të shikojë mundësinë e përfshirjes së dispozitës e cila do t’i definonte rastet kur deputetët ndihen të ofenduar nga kryesuesi në mënyrë që të shmanget paknaqësia midis deputetëve.

- Në seancën plenare të 14 shtatorit, gjatë debatit të interpelancës së ORA-s për Ministrin për Arsim, z. Džezair Murati (6+/Vakat) kërkoi nga Kryesuesi që t’i krijojë kushte për të folur, duke komentuar se “deputetët që nuk janë të interesuar të dëgjojnë mund ta lëshojnë sallën plenare”. Në sallën plenare kishte zhurmë kur z. Murati filloi deklaratën e tij sepse disa deputetë po flisnin ndërmjet vete me zë. Z. Murati e pyeti z. Sabri Hamiti (LDK), i cili në atë moment po fliste me një deputet tjetër, “z. Hamiti, a do të dëgjoni?”. Z. Hamiti u përgjigj “jo”. Z. Murati u përgjigj “nëse nuk doni të dëgjoni atëherë lëshojeni sallën,” dhe vazhdoi deklaratën e tij. Kryesuesi nuk intervenoi gjatë fjalosjes në mes të z. Murati dhe z. Hamiti.
Sipas rregullës 22.10, Kryetari i Kuvendit apo Kryesuesi është përgjegjës për mbajtjen e rendit në mbledhjet e Kuvendit. Situatat si ajo më sipër janë të përshtatshme për Kryetarin apo kryesuesin që të ndërhyjnë për ta mbajtur rendin në seancë dhe për t’u mundësuar deputetëve që t’i bëjnë deklaratat e tyre pa pengesa.

Shpërndarja e projektligjeve

- Projektligji për mbështetjen financiare familjeve me fëmijë me paaftësi të përhershme u është shpërndarë deputetëve më 5 korrik. Andaj, projektligji është shpërndarë 17 ditë pune para shqyrtimit të tij të parë në seancën plenare të 31 korrikut. Projektligji për ndryshimin e ligjit Nr. 2003/11 për rrugët është shpërndarë më 27 qershor, derisa projektligji për vlerësimin e ndikimit në mjedis është shpërndarë më 9 gusht. Andaj, projektligjet janë shpërndarë 42, përkatësisht 11 ditë pune para shqyrtimit të tyre të parë në seancën plenare të 27 gushtit. Projektligji për vlerësimin strategjik të mjedisit është shpërndarë më 20 gusht, projektligji për procedurën jokontestimore, projektligji për procedurën përmbarese dhe projektligji për procedurën kontestimore janë shpërndarë më 29 gusht, derisa projektligji për të drejtat dhe obligimet e deputetëve të Kuvendit është shpërndarë më 3 shtator. Andaj, projektligjet janë shpërndarë 17, dhjetë, përkatësisht shtatë ditë pune para shqyrtimit të tyre të parë në seancën plenare më 14 shtator.
*Projektligji për projektligji për vlerësimin e ndikimit në mjedis, projektligji për procedurën jokontestimore, projektligji për procedurën përmbarese dhe projektligji për procedurën kontestimore janë shqyrtuar në lexim të parë në pajtim me rregullën 35.1, e cila kërkon që shqyrtimi i parë i projektligjit të bëhet jo më parë se dhjetë ditë pune dhe as më shumë se tri javë pune nga dita e shpërndarjes së tij. Shqyrtimi i parë i projektligjit për mbështetjen financiare familjeve me fëmijë me paaftësi të përhershme, projektligjit për vlerësimin strategjik mjedisor dhe projektligjit për të drejtat dhe obligimet e deputetëve të Kuvendit nuk është bërë në pajtim me rregullën e lartëshënuar.
*Leximi i parë i projektligjit Nr.2003/11 për ndryshimin e Ligjit për rrugët ishte caktuar më herët për shqyrtim në seancën plenare të 12 korrikut dhe ishte shpërndarë në pajtim me rregullën**

35.1, por nuk është shqyrtuar për shkak të mungesës së Ministrit për transport dhe telekomunikacion, i cili e ka sponsoruar ligjin në fjalë dhe duhej ta paraqiste para Kuvendit. Andaj, shqyrtimi i parë i projektligjit për ndryshimin e ligjit Nr. 2003/11 për rrugët është ricalkuar për seancën plenare të 27 gushtit, gjë që e ka vonuar në masë të konsiderueshme miratimin në parim të tij. Kjo thekson nevojën për bashkërendim më të mirë në mes të Qeverisë dhe Kuvendit në mënyrë që të mos shtyhet shqyrtimi dhe miratimi i projektligjeve, posaçërisht në shqyrtimin e parë të tyre.

Procesi legjislativ

- Projektligji për letërnjoftimin është miratuar më shumë se pesë muaj pas shqyrtimit të parë më 22 shkurt. Projektligji për ndërtimet pa leje është miratuar më shumë se shtatë muaj pas miratimit të tij të parë më 14 dhjetor 2006. Projektligjit për ndryshimin e Ligjit Nr. 2004/1 për transportin rrugor është miratuar gati katër muaj pas shqyrtimit të parë më 31 maj. Shqyrtimi i dytë i projektligjit për ushqimin është radhitur më shumë se njëzet muaj pas shqyrtimit të parë më 17 nëntor 2005.

Më 21 shtator, Kryetari i Kuvendit është takuar me kryesuesit e komisioneve për të diskutuar shqyrtimin e projektligjeve të mbetura gjatë pjesës së mbetur të mandatit të Kuvendit. Kryetari i Kuvendit theksoi se 25 projektligje tashmë janë miratuar në shqyrtim të parë dhe janë nëpër komisione, andaj i inkurajoi kryesuesit e komisioneve që ta përshejtojnë shqyrtimin e projektligjeve në mënyrë që të miratohen ato para përfundimit të mandatit të Kuvendit. Kryesuesit e komisioneve premtuan se do ta përshejtojnë shqyrtimin e projektligjeve të mbetura.

Projektligjet e përmendura më lartë nuk janë procesuar nga komisionet në pajtim me rregullën 35.6 e cila parasheh që “Në rastet kur një komision është caktuar ta shqyrtojë projektligjin, atëherë ai i raporton rekomandimet e veta në Kuvend, por jo më vonë se dy muaj nga shqyrtimi i parë i projektligjit, përveç rasteve kur është miratuar një kohëzgjatje shtesë nga Kuvendi”. Komisionet e Kuvendit i kanë paraqitur rekomandimet e tyre në të gjitha projektligjet e lartëpërmendura me një vonesë të konsiderueshme nga afati i përcaktuar me rregullën 35.6, pa kërkuar nga Kuvendi shtyerjen e afatit. Rregulla 63 parasheh që “Në fund të mandatit të Kuvendit të gjitha punët që i janë besuar atij do të konsiderohen të përfunduara. Kjo nuk gjen zbatim në rastin e ligjeve të miratuara nga Kuvendi e të proceduara për shpallje, si dhe të peticioneve dhe të atyre punëve, që nuk kërkojnë të merret një vendim nga Kuvendi”. Andaj, nëse Kuvendi nuk i miraton projektligjet e mbetura deri në fund të mandatit të tij, ato do të duhet t’i parashtrihen përsëri Kuvendit të ardhshëm nga Qeveria e ardhshme.

Interpelanca

Më 31 korrik, në vazhdimin e seancës plenare të filluar më 27 korrik, Kuvendi ka mbajtur debatin për interpelancën e ORA-s parashtruar Kryeministrit lidhur me procesin e tenderimit për licensimin e operatorit të dytë të telefonisë mobile.¹ Kryesuesi ua përkujtoi deputetëve se sipas rregullës 25.7 grupi parlamentar që ka propozuar interpelancën për debat ka të drejtën ta hapë debatin me deklaratë dhjetë minutëshe dhe ta mbyll atë me deklaratë pesë minutëshe, derisa ndarja e kohës gjatë debatit do ta reflektojë përfaqësimin e secilit grup parlamentar në Kuvend. Z. Nazim Jashari (ORA) bëri deklaratën hyrëse pasuar nga Kryeministri, shefat e grupeve parlamentare dhe disa deputetë të tjerë, pas të cilëve z. Jashari bëri deklaratën përmbyllëse. Menjëherë pasi z. Jashari e përfundoi deklaratën përmbyllëse, Kryesuesi e përfundoi debatin dhe

¹ Më 26 qershor, grupi parlamentar ORA ka parashtruar një mocion për interpelancë për Kryeministrin Agim Çeku lidhur me “dështimin e Kryeministrit në zbatimin e dispozitës 3.4 të dokumentacionit të tenderit për licencimin e operatorit të dytë të telefonisë mobile, sipas të cilës është dashur të konfiskohen 1.6 milion Euro nga fituesi i parë i përzgjedhur, siç parashihet në nenin 55.1 (c-ii) të Ligjit për prokurim publik, e që drejtpërdrejt ka ndikuar në buxhetin e Kosovës.” Në mocionin e saj, ORA ka rekomanduar që “të formohet një komision parlamentar hetimor për të hetuar përgjegjësinë e të gjithë atyre që e kanë shkelur ligjin dhe rregullat në procesin tenderues.” Për më shumë detaje, shiko raportin 03/2007 të shtyllës së III-të (OSBE) mbi monitorimin e Kuvendit të Kosovës, paragrafi i tretë te pjesa e titulluar “Interpelanca”.

dhe dha pauzë pa e hedhur në votim rekomandimin e ORA-s. Pas pauzës znj. Fatmire Mulhaxha-Kollçaku (ORA) bëri vërejtjen se duke mos e hedhur në votim rekomandimin e ORA-s ishte shkelur rregulla 25.9, dhe kërkoi nga Kryetari i Kuvendit që ta kompensojë këtë.² *Rregulla e ripunuar 25.9 parasheh që “Grupi parlamentar që ka kërkuar interpelancën mund të kërkojë që të votohet një mocion në fund të debatit për interpelancë; në kuadër të kohës së ndarë për të, me kusht që rekomandimi të ketë qenë i përfshirë në kërkesën fillestare për interpelancë.” ORA e ka përfshirë rekomandimin e saj në mocionin për interpelancë ashtu siç kërkohet në rregullën 25.9. Andaj, Kryesuesi është dashur që ta hedhë në votë rekomandimin e ORA-s. Pas pauzës Kryetari i Kuvendit ka mundur ta rregullojë këtë shkelje procedurale duke e hedhur në votim rekomandimin e ORA-s, por nuk e ka bërë këtë.*

- Më 3 gusht grupi parlamentar ORA ka parashtruar një mocion për interpelancë ku ka ftuar Ministrin për Arsim, Shkencë dhe Teknologji, Agim Veliu ta informojë Kuvendin mbi “zbatimin e udhëzimit administrativ 12/2007 lëshuar nga Ministri për Arsim, Shkencë dhe Teknologji lidhur me klasën e pestë.” Në këtë mocion ORA ka rekomanduar që “zbatimi i klasës së pestë të shtyhet për vitin shkollor 2008 sepse përgatitjet e pamjaftueshme mund të kenë ndikim negativ në nxënësit, mësuesit dhe në vetë procesin edukativ.” Më 20 gusht, Kryesia është pajtuar që mocionin për interpelancë t’ia përcjellë Qeverisë. Më 5 shtator, Ministri për Arsim, Shkencë dhe Teknologji i ka dërguar letër Kryesisë ku ka deklaruar se është i gatshëm t’i përgjigjet interpelancës. Kryesia, në mbledhjen e saj të mbajtur më 6 shtator e ka radhitur debatin e interpelancës për seancën plenare të 14 shtatorit.

Në seancën plenare të 14 shtatorit, z. Genc Gorani (ORA) bëri deklaratën hyrëse, pasuar nga Ministri për Arsim, Shkencë dhe Teknologji, shefat e grupeve parlamentare dhe disa deputetë të tjerë, pas të cilëve z. Gorani bëri deklaratën përmbyllëse. Pasi z. Gorani e ka përfunduar deklaratën e tij përmbyllëse, Kryesuesi³ e hedhi në votim rekomandimin e ORA-s. Në atë moment, z. Alush Gashi (LDK), nga ulësja e tij, kërkoi që rekomandimi të mos hedhet në votim. Kryesuesi u përgjigj se ai ishte i obliguar që ta hedhë në votim rekomandimin e ORA-s dhe e bëri këtë. Rekomandimi i ORA-s është refuzuar me njëmbëdhjetë vota për, 39 vota kundër dhe 13 abstenime.

Siç është shpjeguar në paragrafin më lartë, rregulla 25.9 parasheh që rekomandimi të hedhet në votim nëse është përfshirë në mocionin fillestar për interpelancë. Andaj, Kryesuesi e hedhi në votim rekomandimin e ORA-s në pajtim me rregullën 25.9. Deklarata se rekomandimi nuk duhet të hedhet në votim ishte jokorrekte.

Pyetjet për Qeverinë

- Më 31 korrik, në vazhdimin e seancës plenare të filluar më 27 korrik, Kryetari i Kuvendit lajmëroi se nga deputetët janë paraqitur 23 pyetje dhe se pyetjet që nuk do të mund të kryhen më 31 korrik do të radhiten për seancën plenare të radhës. Andaj, 11 pyetje u procesuan më 31 korrik, prej të cilave dhjetë morën përgjigje ndërsa një pyetje nuk mori përgjigje. Kur koha prej 50 minutave për pyetjet e deputetëve përfundoi, z. Naim Maloku (AAK) i cili po e kryesonte seancën në atë kohë deklaroi se kanë mbetur edhe dhjetë pyetje tjera të parashtruara nga deputetët por koha e paraparë për pyetje sipas rregullores kishte kaluar. Ai më tutje deklaroi se nëse Kuvendi dëshironte ta vazhdojë kohën për pyetje duhej së pari të marrë vendim për shmangie nga rregulla 26. Shefat e grupeve parlamentare deklaruan se dhjetë pyetjet e mbetura duhet të shtyhen për seancën e radhës dhe se nuk ka nevojë shmangia nga rregulla 26. Në seancën plenare të 27 gushtit dhjetë nga 18 pyetje morën përgjigje. Në seancën plenare të 14 shtatorit 11 nga 17 pyetje morën përgjigje. Pyetja e z. Nait Hasani (PDK) për Ministrin për Kthim dhe Komunitete Branislav Grbić, e cila ishte shtyrë në seancën e 27 gushtit, përsëri nuk mori përgjigje në seancën plenare të 14 shtatorit për shkak të mungesës së ministrit. Më 27 gusht dhe 14 shtator, z. Hasani ka kërkuar fjalën që gojarisht ta bëjë pyetjen, por nuk është lejuar

² Debatit për interpelancën është kryesuar nga anëtari i Kryesisë Naim Maloku (AAK). Pas pauzës së dhënë nga z. Maloku, Kryetari i Kuvendit rifilloi me kryesimin e seancës.

³ Debatit për interpelancë është kryesuar nga anëtari i Kryesisë Gazmend Muhaxheri (ORA).

ta bëjë. Një pyetje nuk ka marrë përgjigje më 14 shtator për shkak të mungesës së deputetit i cili e kishte parashtruar pyetjen. Në secilën prej seancave plenare nën shqyrtim, Kryetari i Kuvendit apo anëtarë i Kryesisë që kryesonte seancën, janë përgjigjur se pyetjet të cilat nuk kanë marrë përgjigje brenda dy seancave plenare do të publikohen në buletin e Kuvendit.

Rregulla e ripunuar 26.1, mbi “pyetjet me gojë për Qeverinë” parasheh që “rendi i ditës i secilës seancë plenare përfshin kohën për pyetjet, të kufizuar në 50 minuta. Deklarata e Kryesuesit më 31 korrik, sipas të cilës Kuvendi më parë është dashur të shmanget nga rregulla 26.1 për të vazhduar me kohën për pyetjet, është në pajtim me rregulloren e punës.

Sipas rregullës së ripunuar 26.9, “deputeti i cili e parashtron pyetjen në pajtim me Rregulloren e Punës ka të drejtë ta parashtojë pyetjen edhe nëse Qeveria ende nuk e ka përgatitur përgjigjen.” Andaj, është dashur që z. Hasani t’i lejohet ta parashtojë pyetjen e tij gojarisht edhe pse Ministri nuk ishte i pranishëm për të dhënë përgjigjen.

Sipas rregullës së ripunuar 26.11, “nëse pyetja nuk ka marrë përgjigje brenda dy seancave ajo publikohet në Buletin e Kuvendit.” Por, Buletini i Kuvendit nuk përmban pyetjet që i janë parashtruar Qeverisë, prandaj asnjëra nga pyetjet që nuk ka marrë përgjigje nuk është publikuar ndonjëherë.⁴ Në sistemet parlamentare, pyetjet për ministrat paraqesin një mekanizëm të rëndësishëm për mbikëqyrjen e aktiviteteve të ekzekutivit, andaj është e domosdoshme që Kuvendi t’i publikojë në buletin e tij pyetjet e deputetëve që nuk kanë marrë përgjigje brenda afatit të paraparë në rregullën 26.11. Në anën tjetër, është poashtu e këshillueshme që deputetët të jenë të pranishëm në seancat plenare në mënyrë që të marrin përgjigje me kohë në pyetjet e tyre.

5. Qasja

- Gjatë periudhës raportuese, Shtylla e III-të (OSBE) ka pasur qasje në seancat plenare, mbledhjet e rregullta të Kryesisë dhe në mbledhjet e komisioneve. Shtylla e III-të gjithashtu ka pranuar kopjet e dokumentave të shqyrtuara nga Kuvendi si dhe transkriptin e seancave të kaluara.

6. Transparenca

- Radio Televizioni i Kosovës (RTK) ka siguruar transmetimin e drejtpërdrejtë të seancave plenare në fjalë. Publikut dhe monitoruesve institucional iu është mundësuar hyrja në seancat plenare. Kuvendi ka web-faqen (www.assembly-kosova.org) që përmban detaje biografike të deputetëve të Kuvendit, informacione për strukturën dhe funksionimin e Kuvendit, kopje të ligjeve dhe rezolutave të miratuara nga Kuvendi, si dhe informacione të tjera në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze.

7. Rekomandimet kryesore

- Duhet të ketë bashkërendim më të mirë në mes të Kuvendit dhe Qeverisë në mënyrë që të mos ketë vonesë në shqyrtimin dhe miratimin e projektligjeve, posaçërisht në shqyrtim të parë.
- Është e domosdoshme që Kuvendi t’i publikojë në buletin e tij pyetjet e deputetëve që nuk kanë marrë përgjigje brenda afatit të paraparë në Rregulloren e Punës.

FUND.

⁴ Shiko raportet 03/2007, 02/2007, 01/2007, 07/2006, 06/2006 dhe 05/2006 të shtyllës III (OSBE) mbi monitorimin e Kuvendit të Kosovës, pjesën e titulluar “Pyetjet për Qeverinë”.